



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Nr. Prot.: <u>KD</u>	Nr. Prot.: <u>63/2019</u>
Jednica:	Br. Prot.:
Nr. i faqeve: <u>-01-</u>	Data: <u>24.04.19</u>
No. of pages:	Date:
Br. stranica:	Datum:
Prishtinë	

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. I REF. 63/2019

KËSHILLI DREJTUES I OMK-SË, në mbështetje të Nenit 21, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenin 32, paragrafin 1 të Statutit të OMK-së dhe Nenit 24 dhe 25 të Rregullores për Punën e Këshillit Drejtues të OMK-së, në mbledhjen e rregullt të datës 24.04.2019, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Lidhur me taksën administrative për lëshim të certifikatës për të kaluarën etike

- I. Taksa e paguar për lëshim të certifikatës për të kaluarën etike sipas Vendimit të Kuvendit me nr. 06/2019 për caktimin e taksave administrative është e vlefshme në afat kohor prej gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit të certifikatës.
- II. Mjeku i cili ka paguar njëherë taksën administrative ka të drejtë që brenda afatit kohor prej gjashtë (6) muajve të kërkojë lëshimin e certifikatës për të kaluarën etikë deri në tre ekzemplarë.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

KËSHILLI DREJTUES I OMK-SË
NR. I REF. 63/2019 dt. 24.04.2019

Prishtinë, 24.04.2019

Kryetar i Këshillit Drejtues të OMK-së
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.sci

